



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 37-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 30.07.2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, Kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Lulzim Rustemi
3. Naxhije Gashi
4. Arben Salihu
5. Slavisa Trajkovic
6. Franjo Goleme
7. Naim Jahiri

Të tjerë prezent

1. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës
2. Brahim Duriqi, DKA
3. Lindia Jovanovic-ZLK
4. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-sherbisht
5. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-sherbisht
6. Fisnik Dida, OSBE

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 36-të e Komitetit për Komunitete.
2. Informate nga drejtorja e arsimit rreth regjistrimit të nxënësve në shkollë dhe braktisja e shkollave nga nxënësit e komunës së Lipjanit

3. Raporti i ZLK-s
4. Të ndryshme

Pastaj kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime me qe nuk pati vërejtje as plotësime kryesuesi e hodhi ne votim rendin e ditës se propozuar dhe me te gjitha votat prezentë kaloi.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 36-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime, në ekstraktin nga mbledhja e 37-të?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 36-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

II

Informate nga drejtorja e arsimit rreth regjistrimit te nxënësve ne shkolla dhe braktisja e shkollave nga nxënësit e komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Brahim Duriqit nga DKA e cila në pika të shkurta i njoftoi rreth informatës

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin,

Naim Jahiri, me krahasuar me vitin e kaluar a ka ndonjë ndryshim te nxënësve për shkak te migrimit qoftë ne vendet tjera apo nga qyteti ne fshat.

Brahim Duriqi, nuk kemi informatë zyrtare pasi qe me 31 gusht na vije zyrtarisht nga drejtoret e shkollave raportet

Lulzim Rustemi, ka vërejte për ekzekutivin pasi çdo here po vijnë zyrtaret e jo drejtoret dhe atë zyrtaret po njoftohen momentet e fundit dhe kjo nuk është ne rregull. Kam nje pyetje për nxënësit qe do te regjistrohen ne klasën e pare ne shkollën “Vëllezërit Frashri” a do te ketë hapësire te mjaftueshme për këta nxënës?
A kane mbet nxënës te pa notuar. A kane dale konkurset e arsimit?

Brahim Duriqi, Për nxënësit e pa notuar ende nuk kemi raport zyrtar nga drejtoret se sa kane mbete te pa notuar. Konkurset janë publikuar disa dhe pritet edhe disa te publikohen. Ndërsa sa i parkete nxënësve pritet qe te filloj punën shkolla e re e cila është duke u ndërtuar.

Naim Jahiri, une nuk pajtohem me Lulin për ekzekutivin pasi qe ke një informate shume e mire nga Shefi i DKA-s dhe as drejtoresha nuk do te kishe çka të shtonte ma shume.

Lulzim Rrustemi, edhe unë nuk pajtona me Naimin pasi që disa herë drejtoret po janë ta pa kujdesshëm dhe nuk po marrin pjesë në takime por po i delegojnë vetëm zyrtaret edhe atë në momentet e fundit.

Arben Salihu, për shkak të vëllimit të madh të nxënësve për në shkollën “Vëllezërit Frashri” a do të ketë hapësirë të mjaftueshme për të gjithë këta nxënës

Skender Bikiliqi, e falënderoj Brahimin zyrtarin e DKA-s që ka marr pjesë në këtë takim dhe na ka informuar për gjendjen në arsim pasi që në disa here kemi kërkuar që të na informojnë por nuk kanë marr pjesë por kjo ke një informate e mirë për neve.

Lulzim Qerimi, a keni marr ndonjë veprim për bartjen e nxënësve të lagjes jeta e re apo të Suhadolli .

Brahim Duriqi, nuk e di se çka do të veprojmë me nxënësit e asaj pjesë pasi që aty është në territorin e komunës së Graçanicës ajo pjesë.

Me që diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

III

Raporti i punës së ZLK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikiliqi, ia kaloi fjalën Lidija Jovanovic nga ZLK e cila në pika të shkurta i njoftoi rreth Raporti i punës së ZLK-së

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin,

Lulzim Rrustemi, e falënderoj Ledijen për raportin , kam një pyetje a jeni në dijeni për problem me ujë të pijshëm në Janjevë

Franjo Goleme, a ka mundësi me ditë se kush ka bërë kërkesa për ujë të pijes në Janjevë.

Lidija Jovanovic, janë disa kërkesa të disa qytetarëve por të cilat janë konfidenciale dhe nuk mund të publikojmë.

Lulzim Qerimi, sa i përket problemeve me ujë të pijes në Janjevë deri tani nuk kemi pas asnjë informatë

Skender Bikiliqi, të në Janjevë nuk ka bashkëpunim të mirë në mes të këshillit të fshatit dhe komuniteteve tjera sa i përket kërkesave apo diçka tjetër në interes të fshatit dhe ajo po na shkakton probleme neve si lokalitet

Meqë çështje të tjera nuk pati u kalua në pikën:

IV

Të ndryshme

Naim Jahiri, sa i përket dy familjeve Berisha në fshatin Sllovi a janë ndihmuar ose a ka mundësi të ndihmohen pasi janë në gjendje jo të mirë financiare me kushte të vështira ekonomike.

Ledija Jovanovic, janë ndihmuar vitin e kaluar dhe nuk mundemi prapë të nejtat familje ti ndihmojmë pasi që me rregullore ashtu është e parapamë

Franjo Goleme, ne Janjeve gjate punimeve ne pjesën nalt është dëmtuar gypi i ujit dhe disa familje kane mbete pa ujë te pijes qe disa dite. Është mirë te paktën me cisterna te na bien dikush ujë te pijes pasi qe tani koha me vape dhe po na vështirohet gjendja neve ne atë pjese për shkak te ujit.

Lulzim Qerimi , i njoh familjet Berisha ne Sllovi , i kam vizituar edhe vet janë ne gjendje jo te mire por do te shohim se çfarë do te mund te bëjmë për ato familje.

Naim Jahiri është mire qe te ju behet një zgjidhje atyre familjeve pasi janë ne gjendje jo te mire te paktën me ndonjë donator.

Lulzim Rrustemi, është mire qe kur te punohen projektet banoret e fshatrave te kontaktojnë me menaxherin e projektit dhe te shohin punën te cilën po bëhen.

Skender Bikilqi, ne Janjeve pak ka bashkëpunim mes këshillit te fshatit dhe kjo po na kushton neve si banore. Kam një kërkesë qe te ketë një cisterne me ujë për Janjeven .

Lulzim Qerimi, do te kontaktoj me drejtoratin e shërbimeve publike po ashtu edhe atë te emergjencave për qeshje e cisternës me ujë dhe prishjes se gypit te ujit dhe do ta bëjmë nje zgjidhje.

Skender Bikiqli,ju falënderoj te gjithëve për kontributin po ashtu ju njoftoj qe ne muajin Gusht nuk do te ketë mbledhje për shkak se është muaj i pushimit

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15³⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi